REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
KABINETI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË SHTETIT
SEKTORI PËR KOMUNIKIMIN ME MEDIAN DHE PUBLIKUN

Tiranë, më 09.10.2026

Lënda: Kthim përgjigjje
Drejtuar: Zj. Jona Cenameri

Në përgjigje të kërkesës suaj, informojmë se:

Në mbështetje të ligjit nr.17/2025 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim të Abu Dhabit për Financimin e Projektit "Sistemi i kamerave nën administrim të Policisë së Shtetit-Smart City", midis Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe kompanisë "Presight AL LTD" që vepron nëpërmjet degës së saj në Shqipëri, është nënshkruar Kontrata e Shërbimit me objekt "Sistemi i kamerave nën administrim të Policisë së Shtetit-Smart City".

Kontrata parashikon ofrimin nga Ofruesi i Shërbimit (kompanisë "Presight AL LTD") të pajisjeve, softuerëve dhe shërbimeve të lidhura me implementimin , operimin dhe mirëmbajtjen e paketës së AI Smart City.

Projekti synon të krijojë një platformë/sistem dixhital të integruar dhe të qëndrueshëm për sigurinë publike dhe monitorimin e qytetit inteligjent në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përparuara si inteligjenca artificiale, aftësive të monitorimit në kohë reale dhe automatizimit të proceseve, me qëllim rritjen e sigurisë së brendshme, në funksion të garantimit të rendit dhe sigurisë publike.

Në kontratë, është përcaktuar se përfituesi i këtij projekti është Policia e Shtetit. Implementimi i projektit përbën një hap të rëndësishëm dhe pozitiv për garantimin e rendit dhe sigurisë publike, si dhe përmirëson sigurinë dhe cilësinë e jetës së qytetarëve dhe ndihmon në parandalimin e veprimtarive të paligjshme. Konkretisht:

a. Kamerat inteligjente, sensorët dhe sistemet e monitorimit ndihmojnë në identifikimin e shpejtë të incidenteve dhe reagimin në kohë reale;
b. Analiza e të dhënave ndihmon në identifikimin e zonave me rrezik më të lartë, duke lejuar planifikim më të mirë të patrullimeve;
c. Kamerat dhe sensorët monitorojnë qarkullimin, ndihmojnë në uljen e aksidenteve dhe përmirësojnë kontrollin e shkeljeve të rregullave të trafikut;
d. Platformat dixhitale u mundësojnë qytetarëve të raportojnë incidente dhe të komunikojnë më lehtë me Policinë;
e. Pamjet nga kamerat, të dhënat e sensorëve dhe sistemet e njohjes automatike mund të ndihmojnë në identifikimin e autorëve dhe zbardhjen e ngjarjeve, duke u përdorur në përputhje me ligjin dhe standardet për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në zbatim të Kontratës së Shërbimit të sipërcituar, afateve kohore të zhvillimit të projektit dhe prioriteteve të Policisë së Shtetit, nga ana jonë është proceduar me integrimin në platformat AI të kamerave të instaluara në 20 shkolla (9-vjeçare dhe gjimnaze) të përfshira në projekt. Instalimi dhe integrimi i këtyre kamerave nuk cenon të drejtën e privatësisë, pasi mbulimi i tyre kufizohet në ambiente të përbashkëta, si korridoret dhe oborret e shkollave, me qëllim garantimin e sigurisë së nxënësve, stafit mësimor dhe mjedisit shkollor.

Të dhënat e gjeneruara nga sistemi i kamerave administrohen dhe përpunohen nga strukturat përgjegjëse dhe personeli i autorizuar, në përputhje me kompetencat përkatëse dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Aksesi në këto të dhëna realizohet vetëm për qëllime të ligjshme dhe në funksion të përmbushjes së detyrave institucionale.

Për arsye sigurie, nuk bëhen publike të dhëna të detajuara mbi vendndodhjen e infrastrukturës së ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave, konfigurimin teknik të sistemit dhe mënyrat teknike të aksesimit të tij.

Aktualisht, në zbatim të detyrimeve kontraktuale, ju bëjmë me dije se jemi në fazën përgatitore për krijimin e kushteve dhe infrastrukturës së nevojshme, në funksion të zbatimit të projektit “Sistemi i kamerave nën administrim të Policisë së Shtetit-Smart City”.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit